



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 42, datë 09.05.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 1'633'906'424 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.255, DATË 29.04.2022 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESEA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS"

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 29.04.2022 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkinë Durrës", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit të rindërtimit, në masën 1'633'906'424 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH, nga Bashkia Durrës, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga

e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, për objektet të ndara sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 326'781'285 (treqind e njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 10.05.2022

Tabela e detajimit të fondit

Emërtimi i projektit	Fondi ne lekë
Riforcimi pallateve me kod gis: 20401,21266,24675,5671,5917, 22700 riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Katund i Ri të Shpresim Dapi, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Rrashbull te Blerim Miraka, Isak Gjorga, Isak Allaraj, Jakup Lila, Mefail Mazari, Njazi Dervishi ,Njazi Saliasi riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Sukth te Bektash Pashnjari, Hile Nikolli, Xhevdet Nuraj.	405,606,983
Mbikqyrje	5,820,112
Kolaudim	555,984
Riforcimi pallateve me kod gis: 25373, 24700, 24703 ,riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.4 te Adnan Gjergji, Agako Shuaipi, Ahmet / Armand /Gentian Mandija , Dervish Mani, Enver Turhanaj, Fatmir Subashi, Gani Kazazi, Ikmet Koromani, Klodian Koni, Kosta Lenja, Kujtim Kaziaj, Muharrem Filolli, Nazmi Drenova, Olsi Kapri, Rushit Karici, Shpetim Zela, Tod Begu, Yzeir Suli.	378,420,129
Mbikqyrje	4,832,647
Kolaudim	467,676
Riforcimi pallateve me kod gis: 26311, 26028, 26194, 25958, 27429, 5403 ,riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.1 te Albina Biduli,Kujtim Cankja, Mustafa Biduli, Myzejen Xhakozi, Nexhmije Kapexhiu, Ylvia Bekteshi, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.2 te Mynyre Zeneli, Qazim Terniqi, Saimir Farruku, Violeta Çeka, Vjollca Verzivolli,riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.5 te Agim Gjini, Ferik Hoxha, Lush Zina, Naim Mandri, Neritan Sulejmani, Nikoll Dunga, Shpetim Hoxhaj, Skender / Viktor Golemi, Spanja Perfundi riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.6 te Besi Hilaj, Ilirjan Rusi, Rakip Allmeta, Sami Tafa, Tefta Hidri,	384,084,241
Mbikqyrje	5,509,923
Kolaudim	548,585
Riforcimi pallateve me kod gis: 5461-5463, 5533, 5548, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Ishem te Bashkim Musta, Flor Çerri, Hill Brahe, Imer Kertusha, Selim Kajmaku, Shpetim Hoxha riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Manez te Altin Prençi, Frano Çuni, Idriz Kopshti, Kurt Nehani, Majlinda Cuni, Ramiz Gjeta, Sherif Gjeta, Vathe Hoxha,	441,784,739
Mbikqyrje	5,721,694
Kolaudim	553,712
TOTALI	1,633,906,424



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. 427 / prot.
10

Durrës, më 16 05 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES

BASHKISË DURRES

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.42 datë 09.05.2022 “Për miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit prej 1.633.906.424 lekë pa TVSH në zbatim të VKM Nr 255 dt 29.04.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit në ndërtesa(pallat), në Bashkinë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

